Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Junikut

Opština Junik - Municipality of Junik

---

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
02/Nr. Prot. 01-180-7839
Nr. i faq. 6
Data 09/12/2020

# KONTRATA

Titulli i tenderit: Asfaltimi i rrugës Junik- Gjocaj / Punë shtesë

Numri i prokurimit: **636-20-8164-5-2-5**

Numri i brendshëm: 636-20-008-521/5

Data: 09.12.2020

**Komuna e Junikut** (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"),e përfaqësuar nga U.D. Zyrtaria Përgjegjëse e Prokurimit, Florinda Kukalaj në njërën anë, dhe

**Operatori Ekonomik Joos&Krasniqi sh.p.k (ne vazhdim "Kontraktuesi"),** me numër të regjistrimit të biznesit dhe me numër fiskal 810962309, me adrese 51 050, Junik, me numër kontaktues: 048-999-014 dhe email: granit.krasniqi@jooskrasniqi.com e përfaqësuar nga Agron Krasniqi ne anën tjetër, **janë pajtuar te lidhin një ankes-kontrate publike për punët e shënuara me poshtë:**

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Numri i prokurimit | 636 | 2 | 0 | 8 | 1 | 6 | 4 | 5 | 2 | 5 |
| Numri i brendshëm | 636 | | 2 | 0 | 0 | 0 | 8 | 5 | 2 | 1/5 |

**Neni 1 Lënda**

Lënda e kontratës do të jetë **Asfaltimi i rrugës Junik- Gjocaj**/ Punë shtesë

1.1 Kontrata hynë në fuqi me 09.12.2020 dhe përfundon me 31.12.2020.

1.2 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 30 ditë nga data e marrjes së urdhëreses.

1.3 Vendi i kryerjes së punëve do të jetë rruga Junik- Gjocaj.

1.4 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP[1] (Detyra e Dërguar e Paguar).

---

[1] DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

**Neni 2 Ligji i aplikueshëm**

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

**Neni 3 Çmimi**

3.1 Cmimi total i aneks kontratës do të jetë: 20,000.00€; Njëzetemijë euro e zero cent.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

**Neni 4 Pagesat**

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale te pagesës pas pranimit të tërë dërgesës

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

**Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën**

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

**Neni 6 Kualiteti**

6.1 Kualiteti i punëve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

**Neni 7 Garancioni**

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të punëve.

**Neni 8 Vonesat në ekzekutim**

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin te kryej ndonjë ose te gjitha punët brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së punëve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

**Neni 9 Inspektimi dhe testimi**

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

**Neni 10 Nën-kontraktimi**

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

**Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues**

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judikata;* g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

**Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik**

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

**Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Pejë- Dega në Deç*an* në pajtim me ligjin e Kosovës.

**Neni 14 Komunikimi**

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin ei identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhen shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

| Për Operatorin Ekonomik: Joos&Krasniqi-Bazë sh.p.k | | Për Autoritetin Kontraktues- Komuna Junik | |
|---|---|---|---|
| Emri: | Agron Krasniqi | Emri: | Florinda Kukalaj |
| Pozita: | Drejtor | Pozita: | U.D. Zyrtare Përgjegjëse e Prokurimit |
| Nënshkrimi: | | Nënshkrimi: | |
| Data: | 09.12.2020 | Data: | 09.12.2020 |
| Vula: | | Vula: | |

Paramasa dhe parallogaria

| Paramasa dhe Parallogaria për projektin me titull: "Asfaltimi i rrugës Junik - Gjocaj" | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Nr. | PËRSHKRIMI I POZICIONIT | Njësia | Sasia | Çmimi njesi me TVSH | Shuma me TVSH |
| **1** | **Punët paraprake** | | | | |
| 1.1 | Inqizime të duhura gjeodezike dhe shënimi i trasesë me shenja stabile kontrolluese para fillimit dhe gjatë ekzekutimit të punimeve | m` | 300.00 | 0.6 | 180.00 |
| 1.2 | Prerja e drunjëve dhe pastrimi i trasesë nga shkurret dhe drunjët në tërë trasenë e rrugës | m` | 200.00 | 0.5 | 100.00 |
| | **Totali i punëve paraprake** | | | | **280.00** |
| **2** | **Punimet e gërmimit dhe ngjeshjes** | | | | |
| 2.1 | Gërmimi i gjerë i trupit të rrugës të kategorisë së III-të dhe IV-të për rrafshimin e bazës me thellësi mesatare në raport me niveleten e rrugës, materiali bartet në deponi | $m^3$ | 900.00 | 2 | 1,800.00 |
| 2.2 | Gërmimi i dheut të kategorisë së III-të dhe IV-të për hapjen dhe rrafshimin e bazës me thellësi mesatare në raport me niveleten e rrugës, materiali të bartet në deponi | $m^3$ | 5,500.00 | 0 | - |
| 2.3 | Furnizimi dhe mbushja me material jokoherent guror të granuluar (sipas standardeve relevante) të sjellur nga huaza me bartje, shtrirje dhe ngjeshje 45 MN/m2 me CBR>5% | $m^3$ | 780.00 | 5 | 3,900.00 |
| 2.4 | Planifikimi dhe ngjeshja e siperfaqës së bazës së rrugës, ngjeshmeria jo me e vogël se 30 $MN/mm^2$. Ndërkaq materiali i tepërt të bartet në deponi | $m^2$ | 1,800.00 | 0.1 | 180.00 |
| 2.5 | Gërmimi i kanaleve anësore të kategorisë së III-të dhe IV-të, materiali bartet në deponi | m' | 200.00 | 2 | 400.00 |
| | **Totali i punimeve të gërmimit dhe ngjeshjes** | | | | **6,280.00** |
| **3** | **Punimet e zhavorrit** | | | | |
| 3.1 | Furnizimi, transporti dhe shtrirja e zhavorrit 0-63mm, me trashësi mesatare d=0.20cm sipas niveletës së rrugës pas ngjeshjes | $m^3$ | 445.00 | 3 | 1,335.00 |
| 3.2 | Furnizimi, transporti dhe shtrirja e zhavorrit 0-31.5mm, me trashësi mesatare d=0.10cm sipas niveletës së rrugës pas ngjeshjes | $m^3$ | 220.00 | 3 | 660.00 |
| | **Totali i punimeve të zhavorrit** | | | | **1,995.00** |
| **4** | **Punimet e lëshesave gypore (6 copë)** | | | | |
| 4.1 | Gërmimi i dheut të kategorisë së III-të për rrafshimin e bazës për vendosjen e lëshesave gypore | $m^3$ | 30 | 0 | - |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 4.2 | Furnizimi, vendosja dhe nivelizimi i gypave Φ 6000 mm për krijimin e leshesës gypore si dhe furnizimi dhe betonimi i shtresës së eperme me beton armë me trashësi 10 cm dhe rrjete armature fi 8- 15815, | m' | 35 | 0 | - |
| 4.3 | Fornizimi vendosja dhe nivelizimi I : gypave Φ 8000 mm per krijimin e lesheses gypore si dhe furnizimi dhe betonimi I shtreses se eperme me beton arme me trashesi 10 cm dhe rrjete armature fi 8- 15815, | m' | 6 | 0 | - |
| | **Totali i punimeve të leshesave gypore** | | | | - |
| **5** | **Punimet e murit mbajtës** | | | | |
| 5.1 | Gërmimi i bazamentit të murit, dhe të kategorisë së III-të dhe IV-të. Bartja e dheut të tepërt në deponi deri ne 5 km | $m^3$ | 63.00 | 0.00 | - |
| 5.2 | Furnizimi, sjellja dhe betonimi i themelit të murit mbajtës (dim 1.5x0.6 m) me beton të klasës C-25/30 | $m^3$ | 63.00 | 0.00 | - |
| 5.3 | Furnizimi, sjellja dhe betonimi i murit mbajtës (dim sipas projektit) me beton të klasës C-25/30 | $m^3$ | 56.00 | 0.00 | - |
| 5.4 | Furnizimi, bartja dhe punimi i armaturës sipas projektit për armimin e murit mbajtës dhe themelit | kg | 3,200.00 | 0.00 | - |
| | **Totali i punimeve të murit mbajtës** | | | | - |
| **6** | **Punimet e asfaltit** | | | | |
| 6.1 | Furnizimi, transporti dhe punimi i shteresës së asfaltit me trashësi t=10.00 cm pas ngjeshjes adekuate. Karakteristikat e asfaltit: fraksionet e agregatit >2mm...../45-82.50%; fraksionet e agregatit >2mm...../12-32.66%; pjesa për mbushjen e poreve <0.09mm...../4-10%; materiali lidhes - bitumen B 50/70...../5,3 - 6,5%; shkalla e ngjeshjes .....> 97% | $m^2$ | 1,600.00 | 7 | 11,200.00 |
| 6.2 | Furnizimi, transporti dhe punimi i bankinave me material guror jokoherent aty ku lejojnë mundësite | $m^3$ | 49 | 5 | 245.00 |
| 6.3 | Sinjalizimi horizontal me vijë të bardhë 12 cm përgjatë tërë rrugës | m' | 3000 | 0 | - |
| | **Totali i punimeve të asfaltit** | | | | 11,445.00 |
| **7** | **Hapja e rrugës Malok- fshati Gjocaj** | | | | |
| 7.1 | Inqizime të duhura gjeodezike dhe shënimi i trasesë me shenja stabile kontrolluese para fillimit dhe gjatë ekzekutimit të punimeve | m' | 1,150.00 | 0 | - |
| 7.2 | Gërmimi I dheut të kategorisë së III-të dhe IV-të për hapjen dhe rrafshimin e rrugës me thellësi mesatare në raport me niveleten e rrugës, materiali bartet në deponi | $m^3$ | 6,950.00 | 0 | - |
| 7.3 | Furnizimi dhe mbushja me material jokoherent guror të granuluar (sipas standardeve relevante) të sjellur nga huaza me bartje, shtrirje dhe ngjeshje 45 MN/m2 me CBR>5% | $m^3$ | 1,150.00 | 0 | - |
| 7.4 | Furnizimi, transporti dhe shtrirja e zhavorrit 0-63mm, me trashësi mesatare d=0.20cm sipas niveletes së rrugës pas ngjeshjes | $m^3$ | 1,150.00 | 0 | - |
| | **Totali i punimeve për hapjen e rrugës Malok- fshati Gjocaj** | | | | - |
| **8** | **Shqyrtimi i materialit** | | | | |
| 8.1 | Shqyrtimi i materialeve në vend ose sjellja e dëshmive të zhavorrit të përdorur | copë | 2 | 0 | - |
| 8.2 | Shqyrtimet e ngjeshjeve dhe prezantimi i dëshmise me shkrim të rezultateve të shqyrtimit | copë | 20 | 0 | - |
| 8.3 | Shqyrtimi i asfaltit të përdorur/ ekzaminimi i mostrave në vend në prezencë të menaxherit të projektit dhe prezantimi i dëshmive me shkrim të rrezultateve të shqyrtimit | copë | 10 | 0 | - |
| 8.4 | Shqyrtimi i betonit të përdorur/ ekzaminimi i mostrave në vend në prezencë të menaxherit të projektit dhe prezantimi i dëshmive me shkrim të rezultateve të shqyrtimit | copë | 10 | 0 | - |
| | **Totali i shqyrtimit të materialit** | | | | - |

REKAPITULLIM

| | | |
|---|---|---|
| 1 | Punët paraprake | 280.00 € |
| 2 | Punimet e gërmimit dhe ngjeshjes | 6,280.00 € |
| 3 | Punimet e zhavorrit | 1,995.00 € |
| 4 | Punimet e lëshesave gypore | - € |
| 5 | Punët e murit mbajtës | - € |
| 6 | Punimet e asfaltit dhe bankinave | 11,445.00 € |
| 7 | Hapja e rrugës Malok- fshati Gjocaj | - € |
| 8 | Shqyrtimi i materialit | - € |
| | Totali i projektit me TVSH | 20,000.00 € |

**Vërejtje:**

**Realizimi i punimeve do ti nënshtrohet një kontrolli të rrept përsa i përket sasisë dhe cilësisë. Punimet duhet të realizohen në përpikëri sipas projektit dhe paramasës së paraparë nga Njësia e Kërkesës. Asnjë pozicion i punimeve nuk mund të fillohet pa konstatimin e Menaxherit të Projektit që pozicioni paraparë është realizuar me përpikëmëri sipas kritereve të parapara. Mostrat për ateste duhet të merren sipas kërkesave të Menaxherit të Projektit**